



QYTETI I SHKUPIT

Në bazë të pikës 5.1.6 të Programit të aktiviteteve nga sfera e mbrojtjes së mjedisit jetësor dhe natyrës në rajonin e Qytetit të Shkupit për vitin 2018 (Fletorja zyrtare e Qytetit të Shkupit nr. 12/17) Qyteti i Shkupit publikon

THIRRJE PUBLIKE

Për kompensim të një pjese të shpenzimeve të qytetarëve të rajonit të Qytetit të Shkupit për blerje të koftorëve me paleta për vitin 2018

1. Përshkrimi i Thirrjes publike

1.1. Qyteti i Shkupit, me qëllim që të stimulojë qytetarët e Qytetit të Shkupit (amvisëritë) për shfrytëzimin e burimeve të rëpërtërira të energjisë për ngrohje të shtëpive të tyre, të cilët kanë efikasitet më të lartë energjetik dhe në mënyrë minimale ndotin ajrin, banorëve të cilët do të blejnë koftorë me paleta në ditën e publikimit të Thirrjes publike deri më 21 maj 2018, do tu kompensojë një pjesë të shpenzimeve të bëra gjatë furnizimit me koftor me paleta në shumë prej 70% por jo më shumë se 30.000 denarë me tatim të përfshirë personal të të ardhurave për amvisëri.

1.2. Thirrja publike zgjatë 45 ditë kalendarike nga dita e publikimit – prej më 5 prill 2018 deri më 21 maj 2018 ose deri në harxhimin e mjeteve të parapara financiare nga Buxheti i Qytetit të Shkupit për këtë qëllim, varësisht nga ajo se cili kusht do të jetë i pari.

1.3. Nëse harxhohen të gjitha mjetet e parapara nga Buxheti i Qytetit të Shkupit për këtë qëllim, Qyteti i Shkupit do të informojë opinionin në ueb faqen e saj se Thirrja publike është ndërprerë para kalimit të periudhës për çka është publikuar.

1.4. Thirrja publike do të realizohet sipas parimit “i pari i ardhur, i pari i shërbyer”.

2. Të drejtë për pjesëmarrje në Thirrjen publike:

Të drejtë për pjesëmarrje në Thirrje publike kanë banorët e Qytetit të Shkupit (në komunat: Aerodrom, Gazi Babë, Kisella Vodë, Karposh, Çair, Shuto Orizarë, Qendër, Gjorçe Petrov, Butel, Saraj), të cilët do të blejnë koftorë me paleta për ngrohje të hapësirës së tyre (objektit banesor) prej ditës së publikimit të Thirrjes publike deri në ditën e përfundimit të thirrjes, edhe do të parashtrojnë kërkesë për kompensim të një pjese të shpenzimeve për furnizim me koftorë me paleta.

Në thirrje publike nuk kanë të drejtë të marrin pjesë banorët (amvisëritë) që kanë objekt banesor që ka të kyçur ngrohje qendrore të qytetit pavarësisht nëse e përdorin, si dhe pronarët e objekteve banesore që janë në fazë të ndërtimit dhe nuk jetojnë në objektet.

3. Kushtet që duhet të përmbushë kërkuesi:

3.1. Kërkuesi duhet të përmbushë kushtet në vijim:

- Të jetë banor i Qytetit të Shkupit (komunat e qytetit: Aerodrom, Gazi Babë, Kisella Vodë, Karposh, Çair, Shuto Orizarë, Qendër, Gjorçe Petrov, Butel, Saraj);
- Të mos ketë të marrë mjete financiare për furnizim të koftorit me paleta nga cilido burim në Republikën e Maqedonisë;
- Deri në parashttrimin e kërkesës të jetë shfrytëzues i koftorit me thëngjill, dru, naftë dhe mazut;

- Koftorin e ri me paleta ta blejë nga dita e publikimit deri në ditën e përfundimit të Thirrjes publike (45 ditë kalendarike) dhe i njëjti të jetë i instaluar në adresën e banimit të shënuar në letërnjoftim të kërkuetit;

- Objekti banesor të mos jetë në fazë të ndërtimit dhe aty parashtroesi të jetojë;

- *да нема приклуч на градско централно греење во станбеног објект каде што е инсталирана печката на палети без следна тоа други користи*

- Të mos ketë kyçje të ngrohjes qendrore të qytetit në objektin ku është i instaluar koftori me paleta, deri më 2017;

- Vetëm një person i një amvisërie mund të parashtrojë kërkesë për marrje të kompensimit.

3.2. Për kërkuetit që kanë objekt të ri banesor, ndërsa nuk kanë asnjë lloj ngrohje dhe nuk kanë të kyçur ngrohje qendrore të qytetit, nuk vlejnjë kushtet nga pikat 3 dhe 7.

Shënim: Kërkuesi duhet të përmbushë të gjitha kushtet e lartpërmendura në mënyrë që kërkesa e tij të aprovohet. Në të kundërtën, kërkesa e tij do të refuzohet.

4. Mënyra e paraqitjes në Thirrjen publike

4.1. Për kompensimin e një pjese të shpenzimeve dhe të dëshmuarit se kushtet janë të plotësuar, kërkuesi deri te Qyteti i Shkupit dorëzon:

- Kërkesë për kompensim (Kërkesa mund të merret në arkivin e Qytetit të Shkupit ose të sigurohet në internet faqen e Qytetit të Shkupit: www.skopje.gov.mk);

- Kopje të letërnjoftimit valid, si dëshmi se është banor i Qytetit të Shkupit;

- Deklaratë të vërtetuar në noter se kërkuesi dhe familja e tij nuk kanë shfrytëzuar të drejtën për kthim të mjeteve për blerje të koftorit me paleta, në Thirrje tjetër publike nga cilido burim në Republikën e Maqedonisë;

- fotografi të koftorit të cilin e përdorë (dru, thëngjill, naftë ose mazut);

- Dëshmi se është realizuar blerja e koftorit me paleta, edhe atë me llogari fiskale ose faturë me certifikatë nga banka afariste me datë nga data e publikimit të thirrjes deri në ditën e përfundimit të thirrjes publike;

- Kopje të llogarisë së transaksionit;

- Kopje të numrit të kërkesës së parashtuar deri në arkivin e Qytetit të Shkupit për dhënie të vërtetimit për tatim të paguar të pronës për objektin banesor ku është instaluar koftori me paleta deri në vitin 2017 (kërkesa mund të merret në arkivin e Qytetit të Shkupit baraka nr. 16 ose në internet faqen e Qytetit të Shkupit: www.skopje.gov.mk).

4.2. Kërkuetit të cilët kanë objekt të ri banesor, ndërsa nuk kanë asnjë lloj ngrohje dhe nuk kanë të kyçur ngrohje qendrore të qytetit nuk duhet të parashtrojnë dokumentacionin nga pikat 4 dhe 7.

4.3. Kërkuesi duhet të parashtrojë kërkesën dhe dokumentacionin e bashkëngjitur në zarf të mbyllur deri te “Komisioni për realizimin e procedurës për subvencionim të qytetarëve të rajonit të Qytetit të Shkupit për furnizim të koftorëve me paleta” në arkivin e Qytetit të Shkupit, në adresën bul. Ilinden nr. 82, çdo ditë pune prej ora 08:30 deri në ora 16:00.

4.4. Në zarf duhet të qëndrojë: “Thirrje publike për kompensim të një pjese të shpenzimeve për qytetarët në rajonin e Qytetit të Shkupit për blerje të koftorëve me paleta për vitin 2018”.

4.5. Arkivi i Qytetit të Shkupit kërkesat pranuar do t'i evidentojë me kohë të saktë të parashtimit (datë, orë dhe minuta), për shkak të vendosjes së orarit sipas të cilit do të shqyrtohen kërkesat.

5. Mënyra e realizimit të thirrjes publike

5.1. Kryetari i Qytetit të Shkupit formon Komision për realizim të Thirrjes publike, i cili procedurën do ta realizojë në dy faza:

- në fazën e parë Komisioni duhet të shqyrtojë kërkesat e arritura dhe dokumentacionin e parashtuar të bashkëngjitur me qëllim të vërtetimit nëse ato janë të rregulluara dhe kompletuara dhe

- në fazën e dytë do të realizohet kontroll në terren tek të gjithë kërkuetit të cilët kanë parashtuar dokumentacion të rregullt dhe të kompletuar që të vërtetojë se përmbushur kushtet nga kjo Thirrje publike, e posaçërisht se koftori i blerë me paleta është i instaluar në vendbanimin sipas letërnjoftimit të kërkuetit, se nuk ka kyçje të ngrohjes qendrore të qytetit në objektin banesor ku është instaluar koftori me paleta, se objekti banesor nuk është në fazë ndërtimi dhe në të kërkueti jeton.

5.2. Kërkuesi obligohet t'i mundësojë qasje Komisionit deri tek objekti dhe hapësira në të cilën është instaluar koftori i furnizuar me paleta.

5.3. Për kërkesat e arritura dhe të përpiluara nga pika 5.1 alineja 1, do të bëhet listë me të dhënat në vijim:

- emri dhe mbiemri dhe adresa,
- data dhe ora e fletëparaqitjes së arritur në Thirrjen publike,
- shumë të kompensimit për kërkuetin dhe shuma e tatimit personal të të ardhurave.

5.4. Paga e mjeteve do të realizohet në mënyrë suksesive, sipas rendit të fletëparaqitjeve të arritura sipas parimit “i pari i ardhur, i pari i shërbyer”, ndërsa pas vendimeve të sjella për miratim të kërkesave nga ana e kryetarit të Qytetit të Shkupit.

6. Mënyra e realizimit të së drejtës së kompensimit

6.1. Kryetari i Qytetit të Shkupit me propozim të Komisionit sjellë vendim për miratim të kërkesës në afat prej 20 ditëve nga dita e përfundimit të

Thirrjes publike për kërkuesit të cilët i kanë përmbushur kushtet nga Kjo Thirrje publike.

6.2. Komisioni i informon kërkuesit në afat prej 7 ditëve nga dita e parashtrimit të kërkesës nëse nuk kanë dokumentacion të rregullt dhe të kompletuar dhe ua kthen të njëjtën të bashkangjitur me lajmërimin.

6.3. Kryetari i Qytetit të Shkupit me propozim të Komisionit do të sjellë Vendim për refuzim të kërkesës në afat prej 20 ditëve nga dita e përfundimit të Thirrjes publike për kërkuesit që nuk përmbushin kushtet sipas kësaj Thirrje publike.